



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesionet e Lira-Departament Slabodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL/ar.16/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryes, Diellza Hoxha dhe Ruzhita Hoxha, anëtarë të komisionit, në vëzhgim disiplinor ndaj përmbaruesit privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore _____ i dyshuar për shkelje disiplinore nga nenet 9, 10, 21, 22, 112, 341, të LPP, dhe nenin 2 të Kodit të Përkohshëm të Etikës për Përmbaruesit Privat, në seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet e Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, z/nj, Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, pala ankuese _____ dhe përmbaruesit privat, _____ pas mbajtjes së seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur me datën 27.08.2020, unanimitisht mori këtë:

V E N D I M

- I. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat, _____ i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë, është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1.2, të LPP-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbaruesi privat, _____ i shqiptohet masa disiplinore "vërejtje," e paraparë me nenin 368 par 1, pika 1.1 të LPP-së.

A r s y e t i m

Me datën 06.07.2020, pala ankuese _____ ka paraqitur ankese në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore _____ për shkak se i njëjti ka kryer një varg shkeljes disiplinore me rastin e ndërmarjes së veprimeve përmbarimore

në lëndën P. nr 374/20. Pala ankuese pretendon që përbaruesi ka lëshuar urdhër për përbarim me datën 12.11.2018 ndërsa në adresën e debitorit asnjëherë nuk është dorëzuar ndonjë dokument nga posta apo personi tjetër; ka ndërmarr veprime të agutshme duke bllokuar llogarinë bankare të debitorit në të cilën ky i fundit realizon pensionin invalidor dhe ka rrezikuar ekzistencën e tij dhe familjes; përbaruesi privat ka kufizuar njetet në llogarinë bankare me shumë se glysmë e fartësisë së tyre, në kundërshtim 112 të LPP-së; përbaruesi është sjellur në mënyrë përgjuesë, arrogante dhe denigruese me debitorin. Tutje, pala ankuese pretendon se me dt 02.05.2019 kur ka tërhequr urdhërin nga zyra e përbaruesit privat dhe kur ka kontaktuar me zyrtarët e KEDS, i njëjti është njoftuar se borxhi i tij ndaj tyre ishte vetëm fatura e fundit në vlerë prej pesëmbëdhjetë Euro e katër centë (15.04 €) kurse për një shumë të tillë debitori është dëmtuar në procedurë gjyqësore dhe ka shpenzuar njeta financiare në vlerë prej treth gjashtëqind Euro (600 €).

Përbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaron që nuk ka pasur sjellje agresive, se procedura ndaj debitorit është bërë sipas propozimit të kreditorit- KEDS për borxh në shumën prej pesëqind e tetëdhjetë e tre euro e gjashtë dhjetë centë (583.60 €). Shton se me datën 14.11.2018 kanë njoftuar debitorin që vullnetarisht ta paguajë borxhin si dhe shpenzimet procedurale por i njëjti ka refuzuar pranimin e propozimit për përbarim pa dhënë ndonjë arsyeim siç edhe vërtetohet nga fletëkthesa. Shton se llogarinë i ka bllokuar pas gjashtë (6) muajve kur pala debitore nuk është lajmëruar fare mirëpo nuk i janë tërhequr njetet, kurse pala debitore ka ushtruar prapësim në gjykatë ku ka theksuar pretendimet e tij. Urdhëri për bllokimin e njetëve është tërhequr pasi pala debitore ka bërë pagesën e borxhit por kjo nuk e liron të njëjtin nga përgjegjësinë e pagesës së shpenzimeve.

Me datën 27.08.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore; pala ankuese dhe përbaruesit privat

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shpjegimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përbaruesit privat duke theksuar se bazuar në ankesën e paraqitur nga pala ankuese me shkrim, këtu përbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, nën par 1.1, 1.2, 1.4, dhe 1.7 të LPP, me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përbarimore lidhur me lëndën P.nr 374/18, si dhe ka tejkaluar autorizimet e tij ligjore.

Pala ankuese theksoi se organi përbarimor-përbaruesi privat ka treguar sjellje jo-profesionale, arrogante dhe të njëanshme në veprimet e tij lidhur me lëndën përbarimore P. nr 374/18, duke shkelur ligjin dhe ka tejkaluar autorizimet ligjore ashtu që, qëllimisht, ka shpërfillur kërkesat legjitime të palës ankuese. Tutje, përbaruesi privat fillimisht nuk i ka dorëzuar fare urdhërin përbarimor dhe se nuk është e vërtetë që ai ndonjëherë ka refuzuar pranimin e tij. Shton se vetëm pasi i janë bllokuar njetet në llogarinë bankare ka kuptuar lidhur me procedurën përbarimore dhe se menjëherë është paraqitur tek përbaruesi privat sipas palës ankuese, përbaruesi ka pasur sjellje arrogante. Përbaruesi, sipas palës ankuese, ka refuzuar të nënshtrohet se kur po i dorëzohet shkresat palës ankuese prandaj ai kur ka pranuar shkresat ka shkruar

datën e pranimit të tyre. Tufje, pala ankuese, theksoi se me bllokimin e llogarisë dhe tërheqjen e mjeteve, përmbaruesi ka rrezikuar dhe cenuar dinjitetin e tij sepse i njëjti me këto mjete zhvilloi jetën e tij.

Përmbaruesi privat deklaroi se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese se organi përbarues, në ndonjë mënyrë, kishte pasur sjellje agresive ndaj palës ankuese përkatësisht debitorit. Përmbaruesi privat thekson që, përkundrazi, përmbaruesi kishte pasur konsideratë në kërkesat e palës ankuese. Shton se ai i kishte ofruar shkresat e lëndës palës ankuese kur i njëjti është paraqitur në zyrën e tij. Përmbaruesi privat thekson se është e vërtetë që ai i ka kërkuar palës ankuese të nënshkruaj pranimin e shkresave në të njëjtën datë dorëzimit ku më parë është theksuar se pala ankuese kishte refuzuar pranimin e propozimit për përbarim. Thekson se kjo nuk ishte mënyra e duhur megjithatë në atë kohë kishte konsideruar që kjo mënyrë e tregon kohën kur pala ankuese kishte refuzuar pranimin e urdhërit si dhe kohën kur realisht pala ankuese kishte pranuar shkresat. Për sa përket bllokimit të llogarisë dhe tërheqjes së mjeteve thekson se kjo është sqaruar në përgjigjen e tij me shkrim dhe ai qëndron pranë atyre të cilat ka theksuar aty lidhur me këtë.

Komisioni gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar: propozim për përbarim dt 12.11.2018; Transaksionet e Konsumatorit 26.06.2020; Transaksionet e Konsumatorit 20.05.2020; Transaksionet e Konsumatorit dt 06.11.2018; Fletëdërgesat për dorëzim personal; Urdhër për bllokimin e llogarive bankare dt 22.03.2019; Propësim dt 13.05.2019; urdhër për lirimin e llogarive bankare dt 15.05.2019; përgjigjja në propësim dt 23.05.2019; Ekstrakt nga libri afarist dt 20.05.2019; aktpërcjellëset.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se i përmbaruesi kryer veprë disiplinore.

Komisioni gjen që përmbaruesi kishte vepruar në kundërshtim me parimet ligjore me rastin e dorëzimit të urdhërit përbarimor palës ankuese. Përmbaruesi privat pretendon që urdhëri i ishte dorëzuar palës ankuese dhe i njëjti ka refuzuar pranimin e tij. Tufje, përmbaruesi pretendon se kur pala ankuese ishte paraqitur në zyrën e tij, ai i ka dhënë urdhërin përbarimor dhe i kishte dhënë palës ankuese që ta nënshkruante pranimin e shkresave në të njëjtën fletëkthesë ku më parë pala ankuese kishte refuzuar që ta pranonte urdhërin përbarimor. Komisioni gjen që kjo mënyrë e dorëzimit të shkresave është në shpërpulje me dispozitat ligjore. Në këtë rast, kur pala ankuese kishte kërkuar urdhërin përbarimor, përmbaruesi privat do të duhej ta udhëzonte palën ankuese që ta nënshkruaj një fletëkthesë të re e cila përmbanë të gjitha informacionet lidhur me pranin dorëzimit e shkresës në fjalë. Kjo nënkupton që përmbaruesi privat do të duhej në fletëdorëzimin e ri të theksonte datën dhe kohën e fletëdorëzimit, dokumentin e dorëzuar dhe të gjitha të dhënat e tjera dhe e njëjta në fund të nënshkruhej nga pala dorëzuese dhe pala pranuese. Në fakt, edhe veç përmbaruesi privat në seancën dëgjimore e theksoi që mënyra në të cilën kishte vepruar me rastin e dorëzimit të urdhërit përbarimor palës ankuese, nuk ishte mënyra e duhur por se kishte vepruar me mendjelehtësi nga ngutia duke mos peshuar rëndësinë e saj. Komisioni vlerëson qëndrimin e përmbaruesit gjatë seancës dëgjimore ku u njëjti e pranon se veprimi i tij me rastin e dorëzimit të shkresave ishte mënyrë e gabuar. Për më tepër, kjo tregon një nivel

ndërgjegjësimit, të kujtimit dhe reflektimit mbi sjelljet e tij, në këtë rast, me të cilat edhe ai vet nuk pajtohet si dhe gatishmërisë e tij për të mos përsëritur ato veprime në të ardhmen në rastet të cilat ai procedon.

Për sa i përket pretendimit se përmbartuesi privat subjekt i kësaj procedure, kishte sjellje arrogante. Komisioni, bazuar në shkruesat e fëndës, nuk gjen që përmbartuesi privat, me ndonjë veprim, kishte vepruar jashtë standardeve etike të sjelljes profesionale. Ankuesi nuk arriti të dëshmojë me asnjë provë se në rastin konkret përmbartuesi privat kishte sjellje në kundërshtim me parimet dhe standardet e kërkuara të sjelljes. Mosmarrëveshjet mes palëve për çështje ligjore, siç është rasti këtu, nuk janë, në thelb, sjellje arrogante. Siç ka theksuar Komisioni edhe në raste tjera që kur palët ndajnë interesa të ndryshme, një lloj i mosmarrëveshjeve mes tyre për çështje juridike është e arsyeshme të pritet sepse palët fillojnë nga qëndrime të ndryshme. Për sa kohë këto mosmarrëveshje nuk çojnë në adresime personale dhe çështje që nuk janë relevante për qëllimin e procedurës, ato nuk përbëjnë vetvetiu shkelje disiplinore. Në rastin në fjalë, Komisioni nuk gjen prova relevante që vërtetojnë sjellje arrogante prandaj, Komisioni vjen në përfundim që ky pretendim është i pabazuar.

Për sa i përket asaj që përmbartuesi provoi ka ndërmarr veprime të ngutshme duke bllokuar llogarinë bankare të debitorit në të cilën ky i fundit realizon pensionin invalider dhe ka rrezikuar ekzistencën e tij dhe familjes dhe se përmbartuesi privat ka kulluar mjedjet në llogarinë bankare me situatë se gjysma e larësisë së tyre, në kundërshtim 112 të LPP-së. Komisioni gjen që pala ankuese ka ushtruar prapësim në gjykatën kompetente lidhur me këto pretendime. Është e rëndësishme të theksohet që Procedurat disiplinore pranë komisionit nuk janë procedura shtesë të procedurave gjyqësore apo zëvendësuese të tyre ku palën adresojnë pretendimet ligjore për të cilat parimisht vendos gjykata. Rrethimisht, Komisioni vlerëson se pretendimi i palës ankuese është i pabazuar.

Komisioni vlerëson se masa e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbartuesit në rastin konkret për sa i përket lëshimeve lidhur me dorëzimin pranimitin e shkruesave. Komisioni vlerëson se masa është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rasisit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmbartuesin si dhe tek përmbartuesit tjerë që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbartimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPI.nr.16/2020, datë 27.08.2020

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Arian ENUE

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ me bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.